



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I JASHTËM I VLERËSIMIT

**RREGULLORE PËR
VEPRIMTARINË DHE
MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË
KOMISIONIT TË JASHTËM TË
VLERËSIMIT DHE
SEKRETARIATIT TEKNIK**

(Miratuar me vendimin nr. _____, datë ___/___/2019 të Mbledhjes së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit)

Në zbatim të Ligjit nr.12/2018, datë 5.3.2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, mbledhja e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit miraton këtë rregullore për veprimtarinë dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Sekretariatit Teknik.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe standarteve që do të zbatohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Sekretariatit Teknik, në mbështetje të tij, në zbatim të ligjit Nr.12/2018 "Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme".

Neni 2 Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje është veprimtaria e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Sekretariatit Teknik, duke përcaktuar:
 - a) Rregullat procedurale të cilat zbatohen nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ose mbledhja e Komisionit, gjatë funksionimit dhe vendimmarrjes së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe mbledhjes së anëtarëve; rregullat e paraqitjes së kërkesës, shpalljes dhe publikimit të vendimeve, si edhe çështje të tjera të lidhura me procesin e vendimmarrjes së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.
 - b) Rregullat mbi organizimin e Sekretariatit Teknik përzgjedhur sipas ligjit Nr. 12/2018, në mbështetje të punës së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit;
 - c) Rregullat e komunikimit dhe ndërveprimit me strukturat mbështetëse referuar nenit 30 të ligjit Nr.12/2018;
 - ç) Rregullat e bashkëpunimit, ndërveprimit, informimit dhe njoftimit të palëve të treta (institucionet publike dhe agjensitë e tjera ligjzbatuese, media dhe publiku, subjekti i vlerësimit) gjatë zhvillimit të procesit të vlerësimit kalimtar të subjekteve që përcakton ligji Nr.12/2018.

Për çështje që nuk gjejnë rregullim nga ligji Nr.12/2018 apo nga kjo Rregullore, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit merr parasysh edhe dispozita të tjera ligjore, sipas natyrës të çështjes.

Neni 3
Parimet e ushtrimit të funksioneve dhe organizimit të
veprimitarisë institucionale

1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin Nr.12/2018, ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjin nNr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, ligjin nr.8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale në administratën shtetërore dhe entet publike”, legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, këtë rregullore dhe akte të tjera nënligjore, brenda kompetencave të dhëna nga ligji dhe në përputhje me qëllimin e ngritjes dhe funksionimit të këtij Komisioni.
2. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit kryen procesin e vlerësimit duke respektuar parimet e:
 - a) Ligjshmërisë dhe Përgjegjësisë;
 - b) Pavarësisë dhe besueshmërisë së procesit;
 - c) Procesit të rregullt ligjor;
 - ç) Proporcionalitetit dhe objektivitetit;
 - d) Paanshmërisë, barazisë dhe efektivitetit;
 - e) Konfidencialitetit, ruajtjes së sekretit shtetëror dhe mbrojtjes së të dhënave personale;
 - f) Transparencës dhe të drejtës së informimit.

Neni 4
Selia, simboli, vula, personaliteti juridik i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit

1. Selia e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit është në adresën: Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Ish Garda e Republikës, Tiranë.
2. Në këtë seli Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit zhvillon veprimtarinë dhe mbledhjet. Seancat dëgjimore do të zhvillohen në varësi të ambienteve të siguruara për zhvillimin e tyre.
3. Simboli i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit vendoset nga Mbledhja e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit nëpërmjet votimit nga shumica, e përbërë nga 2/3 e të gjithë anëtarëve.
4. Vula e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit përmban emblemën e Republikës së Shqipërisë, e rrethuar me mbishkrimin “Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit”.
5. Kryetari merr masat për nxjerrjen e vulës dhe regjistrimin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit me qëllim fitimin e personalitetit juridik pranë organeve kompetente, bazuar në legjislacionin në fuqi.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË JASHTËM TË
VLERËSIMIT DHE SEKRETARIATIT TEKNIK

Seksioni I
Organet drejtuese (Mbledhja e anëtarëve dhe Kryetari)

Neni 5
Kompetencat e Kryetarit

1. Veprimtaria e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit drejtohet dhe bashkërendohet nga Kryetari i zgjedhur sipas përcaktimeve të nenit 24 të ligjit Nr. 12/2018, sipas detyrave të ngarkuara me vendim të Mbledhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, të kësaj rregulloreje dhe legjislacionit të zbatueshëm.
Kryetari i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Mbledhja e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit bashkëpunojnë për drejtimin administrativ dhe veprimtarinë e Komisionit.
2. Në zbatim të kompetencave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, Kryetari i Komisionit:
 - a) Ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të institucionit (Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Sekretariat Teknik);
 - b) Përfaqëson Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit në marrëdhëniet me të tretët dhe informon në çdo rast për to si dhe planifikon me palë të treta trajnime kualifikuese për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit dhe Sekretariatin Teknik;
 - c) I propozon Mbledhjes së anëtarëve të Komisionit për ngritjen e grupeve të punës për të përgatitur projekt-akte, programe, dokumente strategjike apo materiale të nevojshme për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së institucionit (Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Sekretariat Teknik).
 - ç) Nënshkruan të gjitha aktet e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit me përjashtim të vendimeve për rezultatin e vlerësimit, të cilët nënshkruhen nga trupat e vlerësimit;
 - d) Thërret mbledhjen e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit për çdo lloj vendimmarrje, me kërkesë të jo më pak se 3 anëtarëve që paraqesin një çështje për diskutim;
 - dh) Propozon modelin për dhënien ose grumbullimin e informacionit nga publiku si dhe për lejimin e medias;
 - e) Kryen detyra të tjera, të cilat i delegohen nga Mbledhja e anëtarëve të Komisionit për shkak të këtij ligji dhe që nuk u ngarkohen anëtarëve apo trupave të vlerësimit;
 - ë) Drejton shortin sipas parashikimeve të ligjit Nr.12/2018 dhe akteve të tjera të nxjerra në zbatim të tij.

Në mungesë të tij, Kryetari autorizon me shkrim si zëvendësues anëtarin më të vjetër në moshë, duke përcaktuar saktësisht afatin. Në rast të pamundësisë së lëshimit të autorizimit me shkrim, drejtimi i veprimtarisë së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit i kalon automatikisht anëtarit më të vjetër në moshë dhe në rast mungese edhe të këtij të fundit, anëtarit që vjen në radhë më të vjetër në detyrë.

3. Kryetari, sipas rastit dhe kur e çmon të nevojshme, në raste të veçanta për nevoja të institucionit mund të delegojë një detyrë të veçantë për t'u ndjekur edhe nga ndonjë anëtar i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Neni 6

Mbledhja e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit

1. Mbledhja e anëtarëve të Komisionit ushtron, por nuk kufizohet në kompetencat e mëposhtme:
 - a) Miraton politikat e drejtimit dhe funksionimit të institucionit në aspektin administrativ;
 - b) Miraton akte nënligjore dhe të tjera në zbatim të ligjit Nr.12/2018 ose të legjislacionit të zbatueshëm për organet e vlerësimit;

- c) Miraton rregulla të detajuara për çështje specifike dhe drejtimin e përmirësimit e punës institucionale në vijimësi;
- c) Detajon mënyrën për lëshimin e kopjeve të dosjes/dokumenteve që palëve iu vihen në dispozicion;
- d) Identifikon dhe propozon nevojat në vazhdimësi për mbështetje buxhetore dhe logjistike;
- dh) Shqyrton dhe miraton çdo informacion dhe raportim që Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit duhet të kryejë me kërkesë të tij ose të Nënkomisionit Parlamentar të ngritur pranë Komisionit të Sigurisë Kombëtare në Kuvendin e Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e ligjit Nr.12/2018.

Mbledhja e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit ushtron çdo kompetencë tjetër të nevojshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit, përjashtuar kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit të parashikuara në ligjin Nr.12/2018.

Neni 7

Kërkesa për thirrjen dhe rendi i ditës i mbledhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit

1. Mbledhja e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit thirret sa herë është e nevojshme. Kryetari i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit thërret mbledhjen dhe vendos rendin e ditës, datën dhe orën e saj. Rendi i ditës duhet t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve, të paktën 48 orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.
2. Rendi i ditës, shoqërohet me projekt-vendimet që propozohen të merren gjatë mbledhjes, së bashku me çdo të dhënë, projekt-akt, këshillë ligjore, si dhe çdo informacion apo dokument tjetër, i cili do të merret në shqyrtim në mbledhje apo që u shërben diskutimeve.
3. Një çështje e caktuar mund t'i shtohet rendit të ditës së mbledhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit kur kjo i kërkohet me shkrim Kryetarit të Komisionit, jo më vonë se 24 orë përpara mbledhjes, nga të paktën 3 anëtarë.
4. Mbledhja e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit mund të kërkohet në çdo kohë dhe nga jo më pak se 3 anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit të cilët përcaktojnë në kërkesën e tyre edhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje. Në këtë rast, Kryetari i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit thërret mbledhjen dhe vendos datën dhe orarin e saj, jo më vonë se 7 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës dhe njofton menjëherë anëtarët në respektim të procedurave të parashikuara në ligj.
5. Rregullat e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, nuk përbëjnë pengesë për të miratuar kërkesa për ndryshimin e përmbajtjes së një projekt-vendimit që shoqëron rendin e ditës.
6. Nëse të paktën 5 anëtarë të pranishëm në mbledhjen e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit vendosin se një çështje, e cila nuk ishte përfshirë në rendin e ditës, duhet të diskutohet, si dhe t'i jepet zgjidhje në mbledhje, çështja shtohet në rendin e ditës.

Neni 8

Kuorumi dhe vendimmarrja në Mbledhjen e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit

1. Në mbledhjen e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij. Në çdo rast, kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve është jo më pak se 10 anëtarë.
2. Mbledhja e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Votimi bëhet i hapur, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në ligj. Një anëtar i Sekretariatit Teknik i autorizuar, mban shënim dhe regjistron votat e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.
3. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, shtyhet votimi për tu zhvilluar një raund i dytë brenda ditës dhe në rast se edhe në këtë raund, nuk rezulton vendimmarrje, votimi i radhës do të kryhet në mbledhjen pasuese jo më vonë se dy ditë nga e para. Nëse edhe në këtë mbledhje, votimi rezulton i barabartë, vota e Kryetarit është përcaktuese. Vendimmarrja në pikën 3 të këtij neni zbatohet në rastet e votimit të hapur.

Neni 9

Dokumentimi i mbledhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit

1. Kryetari i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit kujdeset që Sekretariati Teknik të marrë të gjitha masat e nevojshme që çdo mbledhje e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme përmes:
 - a) regjistrimit audio;
 - b) procesverbalit me përmbledhjen e diskutimeve
2. Procesverbali me përmbledhjen e diskutimeve që është miratuar me votë të hapur nga Mbledhja e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit dhe anëtari i Sekretariatit Teknik i autorizuar për zbardhjen e mbledhjes.
3. Në rastet e mbledhjeve për çështje personash dhe ku votimi është i fshehtë, nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurën përkatëse.
4. Në pjesën hyrëse të procesverbalit shënohet prezenca e anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje. Çdo anëtar i Komisionit që ishte i pranishëm në mbledhje mund të vërë në dukje pasaktësi në përmbajtjen e procesverbalit të përmbledhur dhe të kërkojë korigjimin e tij. Në qoftë se regjistrimi audio apo kontrolli manual, konfirmon pasaktësinë e zbardhjes, përmbledhja e procesverbalit të Mbledhjes së anëtarëve të Komisionit korigjohet dhe miratohet në mbledhjen pasardhëse.
5. Procesverbali me përmbledhjen e diskutimeve të çdo mbledhjeje përmban të paktën informacionet e mëposhtme për:
 - a) Anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit të pranishëm në diskutim për çdo çështje të rendit të ditës;
 - b) Çështjet e rendit të ditës, përfshirë çështjet e shtuara sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje;
 - c) Aspektet kryesore të çështjeve të diskutuara dhe propozimet për vendime;
 - ç) Rezultatit e votimit, mënyrën e votimit të secilit anëtar të Komisionit;
 - d) Vendimet e marra në mbledhje.
6. Në çdo rast, çdo anëtar i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit ka të drejtë të shpjegojë votën ose vërejtjen e tij lidhur me vendimmarrjen e mbledhjes së Komisionit.

7. Dokumentacioni i mbledhjes mbahet sipas legjislacionit në fuqi, që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjale dhe ligjit Nr.9154 datë 6.11.2003, “Për arkivat”.

SEKSIONI II

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë disiplinore të anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Sekretariatit Teknik

Neni 10

Të drejtat e anëtarëve të Komisionit me karakter të përgjithshëm

Anëtari i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe i Sekretariatit Teknik ka të drejtë:

1. Të përfitojë trajtim ose shpërblim financiar të veçantë për punën e kryer;
2. Të përfitojë kohën e pushimit dhe të lejes sipas legjislacionit në fuqi të punës;
3. Të ketë kushte pune të përshtatshme me detyrën që kryen, si dhe të kërkojë trajtim më të mirë apo mjete të nevojshme për ushtrimin e detyrës, sipas rastit;
4. Të trajnohet sipas nevojës, brenda dhe jashtë vendit, pa cenuar funksionimin normal të institucionit, pasi të ketë marrë më parë pëlqimin e Mbledhjes së Komisionit ose, sipas rastit, të Kryetarit të Komisionit;
5. Të kryejë veprimtari me karakter shkencor ose mësimdhënës pa penguar veprimtarinë e institucionit dhe pasi të kenë marrë pëlqimin nga Kryetari apo Mbledhja e anëtarëve, sipas rastit.

Veprimtaritë e mësipërme sipas pikës 4 dhe 5 lejohen, pa iu cenuar e drejta e pagës, nëse:

- a) Janë në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
- b) Nuk krijojnë perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
- c) Nuk bien ndesh me interesat thelbësore të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe efikasitetin në ushtrimin e funksionit.

Anëtari i Komisionit, para se të fillojë veprimtarinë e paguar jashtë funksionit, duhet të njoftojë Mbledhjen e anëtarëve, duke i paraqitur dokumentacionin që përshkruan natyrën e punës, periudhën dhe kohëzgjatjen e saj. Kryetari i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit administron dhe regjistron sipas rastit, veprimtarinë e lejuar për çdo anëtar të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe të Sekretariatit Teknik.

Neni 11

Detyrat dhe kompetencat e anëtarit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit me karakter të përgjithshëm dhe të posaçëm

Krahas detyrave të veçanta të lidhura me pozicionin e punës të përcaktuara në nenin 25 të ligjit Nr. 12/2018, anëtari i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit duhet gjithashtu:

1. Të punojë me përkushtim dhe frymën e bashkëpunimit, me profesionalizëm, ndershmëri, paañesi dhe efikasitet me qëllim përmbushjen e detyrës në të cilën është emëruar, në përputhje me ligjin Nr. 12/2018 si dhe legjislacionit referues;
2. Të ketë në vëmendje udhëzimet e përgjithshme të dala nga Mbledhja e anëtarëve të Komisionit dhe ato të veçanta nga Kryetari;
3. Të veprojë në përputhje me normat etike të sjelljes, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

4. Të paraqitet në detyrë me veshje të përshtatshme dhe serioze, për të përfaqësuar sa më denjësisht Komisionin dhe imazhin e tij, si dhe të mbajë vazhdimisht brenda mjediseve funksionale të Komisionit kartën zyrtare të identifikimit me fotografi dhe/ose të dhëna të tjera;
5. Të njoftojë Kryetarin për mungesën në punë, në rastet e mosparaqitjes për arsye shëndetësore, personale ose vonesë. Gjatë orarit zyrtar të punës, anëtari i Komisionit mund të largohet për arsye pune, shëndetësore ose arsye të tjera të justifikueshme, me vënie në dijeni të Kryetarit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Neni 12

Përgjegjësia disiplinore e anëtarit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit

Anëtarët e Komisionit kanë përgjegjësi disiplinore sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit Nr.12/2018.

Procedimi disiplinor fillon sipas procedurave të nenit 28 të këtij ligji.

Kryetari i Komisionit drejton procedurën e shortit. Brenda 48 orëve nga zgjedhja e komisionit *ad hoc* të përzgjedhur nga shorti me përbërje jo më pak se tre anëtarë, Komisioni fillon shqyrtimin paraprak të rastit. Në rast se Komisioni konstaton se kërkesa nuk përbën bazë për fillimin e procedimit, me vendim vendos mosfillimin.

Në rast të fillimit të procedimit, zbatohen procedurat e përcaktuara në nenin 28 të ligjit Nr. 12/2018 dhe të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 13

Zëvendësimi i vakancave të anëtarëve të Komisionit Jashtëm të Vlerësimit

Anëtari i Komisionit zëvendësohet bazuar në procedurat ligjore sipas përcaktimeve në nenin 9, 11, 13 dhe 24 të ligjit Nr. 12/2018.

Neni 14

Statusi dhe funksionet e Sekretariatit Teknik

1. Sekretariati Teknik përbën bërthamën ndihmëse dhe këshillimore dhe mbështet punën profesionale të anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit. Sekretariati Teknik me kërkesë të anëtarit të Komisionit, bën verifikime dhe kërkime ligjore e financiare apo të tjera dhe përgatit studime dhe analiza me shkrim për problematika të karakterit procedural dhe material të lidhur me dosjen në vlerësim.
2. Sekretariati ushtron detyrat e përcaktuara në nenin 25 dhe 26 të ligjit Nr. 12/2018, duke përfshirë edhe detyra të tjera të caktuara nga trupa vlerësuese gjatë procesit të përgatitjes së çështjes deri në zbardhjen e vendimit, por duke mos përjashtuar detyra të tjera me natyrë administrative.
3. Hapat proceduralë për metodologjinë e ndarjes së punës midis anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe anëtarëve të Sekretariatit Teknik, përcaktohen me akte të brendshme të Komisionit.

4. Në raste të dorëheqjes apo mungesës së përhershme /pamundësisë për të ushtruar funksionin e ngarkuar në Sekretariatit Teknik, Mbledhja e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit vijon me zëvendësimin e anëtarit të ri të Sekretariatit duke përzgjedhur kandidatin e radhës në listën e përzgjedhur të këtyre kandidatëve nga Bordi i Përzgjedhjes, sipas preçaktimeve të nenit 12, 13 dhe 24 të ligjit Nr.12/2018.
5. Në rast të mungesës së përkohshme, anëtari i Sekretariatit Teknik, njofton menjëherë lidhur me arsyen dhe kohëzgjatjen e mungesës. Trupa vlerësuese merr vendim për zëvendësimin e anëtarit të Sekretariatit Teknik në rast të mungesës prej më shumë se 5 ditë pune duke aplikuar procedurën e shortit.

Anëtarët e Sekretariatit Teknik gëzojnë të drejtat dhe i nënshtrohen detyrimeve të parashikuara në ligjin Nr.12/2018, Kodin e Punës, këtë rregullore dhe çdo legjislacion tjetër, për aq sa ai gjen zbatim.

Neni 15

Përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të Sekretariatit Teknik

1. Sekretariati Teknik i nënshtrohet procedurës së shqyrtimit dhe marrjes së masave disiplinore proporcionale në raport me shkeljen e kryer, deri në vendimin për shkarkimin nga detyra, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.
2. Rastet e konfliktit, thyerjes së konfidencës si dhe shkelje të tjera të aplikueshme për anëtarët e Komisionit sipas nenit 27 të ligjit Nr.12/2018 dhe zhvillimi i procedurave për hetimin disiplinor sipas nenit 28 të këtij ligji, bëhen të zbatueshme rast pas rasti në trajtimin dhe zgjidhjen e shkeljes disiplinore edhe për anëtarët e Sekretariatit Teknik.

KREU III

ORGANIZIMI I TRUPËS VLERËSUESE

Neni 16

Organizimi i trupës vlerësuese

1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit organizohet në 5 trupa vlerësuese të përbëra nga 3 anëtarë, të cilët caktohen me short.
2. Çështjet, pasi janë regjistruar, u shpërndahen trupave vlerësuese përmes procedurës së shortit. Radha e shqyrtimit të çështjeve është ajo e përcaktuar në nenin 6, pika 1 të ligjit Nr. 12/2018.
3. Procedura e shortit ndiqet edhe për caktimin e relatorit dhe për kryesuesin e trupës vlerësuese.
4. Kryetari i Komisionit drejton procedurën e shortit.
5. Procedura e shortit realizohet në rrugë manuale, bazuar në parimet e transparencës dhe të objektivitetit. Procedurat e hedhjes së shortit detajohen me akt të posaçëm të Komisionit. Shorti manual hidhet në një orë të përshtatshme të njoftuar më parë nga Kryetari i Komisionit, sipas mënyrës së përcaktuar në manualin e hedhjes së shortit.
6. Në rast se anëtari i institucioneve të vlerësimit nuk mund të shqyrtojë një çështje që i është caktuar për shkaqet e përmendura në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative ose të

ligjit Nr.9367 datë 7/4/2005 “Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, ai njofton me shkrim menjëherë trupën vlerësuese. Përjashtimi i anëtarit të Komisionit nga shqyrtimi i çështjes vendoset nga një tjetër trupë që caktohet me short.

7. Kur një anëtar i Komisionit, për shkaqe shërbimi, shëndetësore ose për shkaqe të tjera objektive nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes dhe në rast se shqyrtimi paraprak nuk mund të shtyhet, ai zëvendësohet nga një anëtar tjetër i Komisionit i caktuar me short.
8. Pas hedhjes së shortit, të dhënat për çështjen, trupën vlerësuese dhe relatorin publikohen.

Neni 17

Drejtimi i trupave vlerësuese

1. Trupat vlerësuese krijohen duke patur parasysh përbërjen e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit të përcaktuar në nenin 9 të ligjit Nr.12/2018.
2. Çdo trupë vlerësuese do të ketë në përbërje të saj tre anëtarë:
 - Një anëtar të përfaqësuar nga 5 anëtarët fitues të përzgjedhur nga Bordi Përzgjedhës nga konkurrimi i hapur;
 - Një anëtar të përfaqësuar nga 5 anëtarët e caktuar nga ILDKPKI;
 - Një anëtar të përfaqësuar nga radhët e pedagogëve.
3. Zgjedhja e kryesuesit dhe relatorit bëhet me short të organizuar nga Kryetari i Komisionit.

Neni 18

Rastet e konfliktit të interesit dhe pengesat ligjore

1. Anëtari i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit nuk mund të shqyrtojë një çështje nëse ekziston një nga shkaqet e parashikuara në ligjin Nr.9367 datë 7/4//2005 “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative.
2. Anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit përpara marrjes së detyrës nënshkruajnë deklaratën sipas nenit 27, pika 1 të ligjit Nr.12/2018 si dhe për çdo rast, deklaratën e konfliktit të interesit rast pas rasti sipas rregullores së shortit të miratuar nga Komisioni.
3. Për çdo rast, anëtari i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit zbaton kuadrin ligjor për deklarimin, parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit.
4. Mbledhja e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit merr vendim për miratimin e modelit të këtyre deklarimeve.

Neni 19

Vetëdeklarimi i pengesave ligjore dhe kërkesa për përjashtim

1. Anëtari i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten apo për një anëtar tjetër të trupës vlerësuese lidhur me një çështje, është i detyruar të deklarojë menjëherë me shkrim natyrën e interesit ose pengesës duke njoftuar trupën vlerësuese. Ai nuk mund të marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse dhe as në votimin e saj deri në marrjen e vendimit nga ana e trupit tjetër vlerësues.
2. Çdo person, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për një anëtar të trupës vlerësuese lidhur me një çështje, mund të njoftojë trupën vlerësuese me shkrim duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi.

Neni 20

Vendimmarrja dhe efektet e përjashtimit të anëtarit të trupës vlerësuese

1. Trupa vlerësuese e njoftuar sipas pikës 1 të nenit 19 të kësaj rregulloreje, me marrjen e kërkesës nga njëri prej anëtarëve të tij apo nga çdo person tjetër, sipas pikës 2 të nenit 19 të kësaj rregulloreje, njofton menjëherë Kryetarin e Komisionit, i cili organizon procedurën e shortit për caktimin e trupës vlerësuese që do të shqyrtojë kërkesën për përjashtimin ose jo të anëtarit nga procedura. Rregullat e parashikuara për organizimin e shortit për çështjet zbatohen dhe në këtë rast.
2. Trupa vlerësuese e caktuar me short sipas pikës 1 të këtij neni merr vendim për përjashtimin ose jo të anëtarit të trupës vlerësuese brenda 5 ditëve nga caktimi i çështjes me short. Nëse trupa vlerësuese vendos përjashtimin e anëtarit nga trupa, ai zëvendësohet nga një prej anëtarëve të tjerë të Komisionit, me short.

KREU IV

DEPOZITIMI DHE ADMINISTRIMI I DOSJEVE TË SUBJEKTEVE TË VLERËSIMIT

Neni 21

Procedura e Depozitimit të Listave Emërore të subjekteve dhe Dosjeve në Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit

1. Para fillimit të shortimit të subjekteve, Kryetari i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit u kërkon institucioneve përgjegjëse, listën emërore të subjekteve që përcaktohen sipas renditjes në nenin 6 të ligjit Nr. 12/2018.
2. Bazuar në listën e subjekteve sipas depozitimit nga institucionet që përcakton neni 6, pika a, b dhe c të ligjit Nr.12/2018, Mbledhja e anëtarëve të Komisionit hedh shortin sipas kësaj hierarkie të përcaktimeve të nenit 6 të këtij ligjit. Pas shortimit të listës së subjekteve, Kryetari i Komisionit u kërkon institucioneve përgjegjëse dosjet e subjekteve të shortuar.
3. Dorëzimi i dosjes së subjektit të vlerësimit bëhet sipas ligjit Nr.12/2018.
4. Për dosjet e depozituara në Komision, punonjësi i ngarkuar për administrimin e dokumentacionit:
 - a) regjistron dhe numëron në regjistrin përkatës;
 - b) krijon fashikullin e çështjes;
 - c) merr masa për shpërndarjen e tij sipas rregullave përkatëse.

Neni 22

Regjistrat e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit

Regjistrat e Komisionit janë si më poshtë:

- a) Regjistri i përgjithshëm i hyrjes dhe daljes së korrespondencës;
- b) Regjistri i përgjithshëm i dosjeve, ku regjistrohen subjektet që i nënshtrohen procesit të vlerësimit ex-officio dhe subjekteve që i nënshtrohen procesit të vlerësimit me kërkesë;
- c) Regjistri i vendimeve dhe të cilave u jepet një numër;
- ç) Regjistri i akteve të miratuara nga Mbledhja e Komisionit;
- d) Regjistri special i korespondencës sekrete dhe konfidenciale, ku regjistrohen dokumentet të cilat kanë këtë karakter;
- dh) Regjistri i arkivit përfshirë arkivimin e dosjeve të subjekteve dhe ruajtjen e procesverbaleve të seancave dëgjimore (audio dhe të zbardhura tekst);
- e) Regjistri i konfliktit të interesit dhe vendimarrjet përkatëse lidhur me to;
- ë) Regjistri i miratuar nga Komisioni për denoncimet e publikut sipas nenit 55 të ligjit Nr.12/2018

Neni 23

Regjistri special i korespondencës sekrete dhe konfidenciale

1. Anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Sekretariatit Teknik duhet të sigurojnë sekretin e të dhënave dhe konfidencialitetin e procedurave dhe të dokumenteve që ato punojnë apo marrin dijeni.
2. Aktet që konsiderohen dokumente të një rëndësie të veçantë caktohen më urdhër të veçantë të Kryetarit të Komisionit dhe regjistrohen në regjistrin special të korespondencës sekrete dhe konfidenciale dhe trajtohen sipas rregullave dhe procedurave të menaxhimit të fondit arkivor.
3. Anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Sekretariatit Teknik nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit.
4. Punonjësi i protokollit/arkivës ka përgjegjësi për evidentimin, regjistrimin, qarkullimin dhe ruajtjen e dokumentacionit hyrës-dalës si dhe të atij që prodhohet nga brenda institucionit (përfshirë atë publik dhe jo publik, si dhe atë sekret shtetëror), dokumentimin dhe sistemimin e tij arkivor pas përfundimit të çështjes apo praktikës përkatëse, si dhe duhet të garantojë sigurinë e ruajtjes së vulave të institucionit bazuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 24

Veprimet paraprake për shpërndarjen e dokumentacionit të trupa vlerësuese

1. Pas përcaktimit me short të trupës vlerësuese dhe anëtarëve të Sekretariatit Teknik, Relatori merr në dorëzim dosjen për shqyrtim.
2. Relatori i çështjes, në bashkëpunim me anëtarin/ët e Sekretariatit Teknik përkatës për këtë trupë kryejnë të gjitha veprimet procedurale si më poshtë:
 - Përgatit dosjen që diskutohet nga trupa vlerësuese me mbështetjen e Sekretariatit Teknik;
 - Ndërmerr të gjitha veprimet për të garantuar provat dhe informacionet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes;
 - Merr të gjitha masat për të hartuar dokumentacionin e nevojshëm deri në përfundimin e çështjes.
3. Pas plotësimit të dosjes me relacionin e përgatitur nga relatori, kryesuesi i trupës vlerësuese cakton datën e seancës dëgjimore.

4. Mënyra e veprimeve procedurale dhe koordinimi i punës brenda trupës vlerësuese përcaktohen më akt të posaçëm të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Neni 25 **Procedura e vlerësimit**

Procedura e vlerësimit realizohet në përputhje me kreun VI të ligjit Nr.12/2018.

Neni 26 **E drejta për t'u njohur me materialet e dosjes**

1. E drejta e informimit garantohet sipas parashikimeve të ligjit Nr.119/2014 “Mbi të drejtën e informimit” dhe mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit. Në raste të tilla, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit konsultohet/merr mendim me shkrim nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 4, pika 3, të ligjit Nr.12/2018.
2. Raporti i relatorit, projektvendimi, çfarëdo informacioni për diskutimin dhe për votimin e trupës, projektvendimet dhe çfarëdo shënimesh të anëtarëve të trupës gjatë diskutimit dhe gjatë shqyrtimit të rastit, mendimet e anëtarëve të Sekretariatit Teknik si dhe materiali tjetër i përcaktuar nga Mbledhja e anëtarëve të Komisionit duhet të jenë konfidencialë dhe në të nuk do të kenë akses as palët e as publiku.
3. Në bazë të kërkesës me shkrim të paraqitur nga çdo person, anëtari i Sekretariati Teknik me miratim të trupës vlerësuese të dosjes përkatëse jep informacion në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni.
4. Data e caktimit për njohjen e dosjes, caktohet si rregull, ditën e enjte, por në varësi të axhendës së punës së trupës vlerësuese.
5. Rregullat e hollësishme për administrimin e dokumentacionit dhe/ose të dhënat për të cilat palëve u kufizohet e drejta e njohjes sipas dispozitave të këtij ligji, përcaktohen në një rregullore të posaçme të miratuar nga Mbledhja e anëtarëve të Komisionit pas udhëzimeve edhe të organeve përkatëse ligjzbatuese.

Neni 27 **Njoftimi i vendimit**

Njoftimi i vendimit të trupës vlerësuese bëhet në zbatim të parashikimeve të nenit 56, pika 8, të ligjit Nr.12/2018 si dhe për sa është e nevojshme, Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 28 **Bashkëpunimi**

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe trupat vlerësuese të tij, gjatë aktivitetit të tyre, bashkëpunojnë me institucione të tjera gjatë vlerësimit të tre komponentëve, sipas parashikimeve të ligjit Nr.12/2018, sipas referencave të neneve 32-47 si dhe neneve 48, 51, 52 nenit 54 dhe publikut sipas nenit 55 të ligjit Nr.12/2018.

Neni 29 **Trajnimi i anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Sekretariatit Teknik**

Anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe të Sekretariatit Teknik para fillimit të detyrës, i nënshtrohen procesit të trajnimit disa javor sipas përcaktimit të nenit 64 të ligjit Nr. 12/2018. Gjatë procesit të hetimit administrativ, trupat e vlerësimit mund të kërkojnë ekspertizën e huaj nga misionet që asistojnë Ministrinë e Brendshme.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 30

1. Brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, Mbledhja e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të shortit, hapat e unifikuar proceduralë si dhe formularë të tjerë për denoncimin e publikut, medias, konfliktit të interesit, konfidencialitetit, etj.
2. Kudo në këtë rregullore, pas numërimit të ligjit Nr. 12/2018, shënohet termi “i ndryshuar”.
3. Kjo rregullore është objekt i rishikimit të Mbledhjes së anëtarëve të Komisionit me kërkesë të të paktën tre anëtarëve të tij. Ndryshimet miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.